REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal

Hartoi

Zyra Për Zhvillimin Ekonomik Dhe Turizmit

Has,mars 2026



Plani Operacional i Zhvillimit Lokal për Bashkinë Has përfaqëson një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të planifikimit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm vendor. Ky plan shënon një nga arritjet e para të administratës së Bashkisë Has në fushën e planifikimit dhe zhvillimit lokal, duke përcaktuar vizionin, prioritetet operacionale dhe projektet kryesore që synojnë përmirësimin e mirëqenies së komunitetit dhe zhvillimin e territorit.

Nga njëra anë, ky plan përbën një dokument të rëndësishëm për planifikimin dhe përdorimin sa më efektiv dhe efiçent të burimeve financiare, njerëzore dhe natyrore, si dhe të aseteve në dispozicion të bashkisë.

Nga ana tjetër, ai shërben gjithashtu si një instrument orientues për hartimin dhe zhvillimin e dokumenteve të të tjera të rëndësishme të planifikimit dhe zhvillimit vendor, duke kontribuar në krijimin e një qasjeje të integruar dhe afatgjatë për zhvillimin e territorit.

Ky plan është hartuar mbi bazën e analizës së situatës aktuale të zhvillimit në Bashkinë Has, duke marrë në konsideratë potencialet lokale, burimet ekzistuese dhe sfidat kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të zonës. Nëpërmjet këtij dokumenti synohet identifikimi i prioriteteve kryesore dhe i projekteve konkrete që do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit lokal.

KRYETAR

Mitat DAUTI

Përmbajtia

Rëndësia e një Plani Operacional për Zhvillimin Lokal 4

Plani Operacional dhe orientimi i investimeve në kuadër të qeverisjes vendore dhe procesit të planifikimit 5

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal (POZHL) 6

Demografia 8

Profili Ekonomik 9

Burimet Natyrore 12

Përcaktimi i problemeve dhe i prioriteteve afatshkurta operacionale 15

Plani operacional Lokal dhe i Investimeve 19

POZHL në kuadër të planifikimit strategjik dhe Territorial 21

Ankeset 21

Figura 1 - Ndarja administrative e Bashkisë Has. 7
Figura 2 - Gurra e fshatit Domaj 13
Figura 3 - Kullë tipike e zonës së Hasit në fshatin Letaj. 14

Tabela 1 - Popullsia e Bashkisë Has sipas grupmoshave. 9
Tabela 2 - Grafiku i numrit të popullsisë dhe i familjeve sipas njësive administrative. 9
Tabela 3 - Lloji i aktiviteteve 11



Rëndësia e një Plani Operacional për Zhvillimin Lokal

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL) është një instrument kyç për drejtimin dhe koordinimin e zhvillimit në nivel bashkie. Ai lind si një nevojë strategjike për bashkitë që të integrojnë strategjitë dhe planet e ndryshme të veprimit dhe zhvillimit, si dhe të sigurojnë një kohezion më të mirë administrativo-territorial pas bashkimit të njësive vendore.

Reforma administrativo-territoriale ka mundësuar që bashkitë të kenë në dispozicion më shumë burime financiare dhe njerëzore, duke trashëguar njëkohësisht sfida të ndryshme nga ish-njësitë vendore. Këto sfida lidhen kryesisht me mungesën e efektivitetit dhe efiçencës në ofrimin e shërbimeve, kufizimet në kapacitetet administrative dhe teknike, si dhe me organizimin e shërbimeve në territore të vogla dhe të fragmentuara. POZHL synon të ndihmojë bashkitë të shfrytëzojnë potencialet e reformës, duke adresuar sfidat e trashëguara dhe duke krijuar një kornizë të qëndrueshme për zhvillimin lokal.

Në përputhje me nenin 28 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Bashkia Has ka hartuar POZHL si një instrument drejtimi afatshkurtër për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Ky plan synon të mbështesë bashkinë në:

- diagnostikimin e gjendjes së zhvillimit lokal në territorin e saj, i cili para reformës ishte i ndarë në disa njësi vendore;
- përcaktimin e vizionit dhe perspektivës afatshkurtra për zhvillimin e territorit;
- identifikimin e drejtimeve dhe prioriteteve operacionale, si dhe të projekteve prioritare;
- mobilizimin dhe përdorimin efektiv të aseteve dhe burimeve njerëzore e financiare në funksion të zhvillimit lokal dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

POZHL ka një rol të veçantë në orientimin e investimeve të bashkisë, pasi:

- lidhet direkt me vizionin e zhvillimit të bashkisë dhe udhëheq proceset e tjera të planifikimit dhe zhvillimit vendor;
- krijon një platformë për shfrytëzimin më efektiv të burimeve financiare dhe njerëzore;
- lidh prioritetet e zhvillimit me procesin e planifikimit buxhetor;
- shërben si referencë për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve zhvillimore;
- mundëson bashkëpunim ndërvendor, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve publike si ujësjellës, transport dhe menaxhimi i mbetjeve;
- orienton dhe nxit zhvillimin e shërbimeve dhe iniciativave që mbulojnë të gjithë territorin, duke siguruar një qasje të integruar të planifikimit lokal.

Ky Plan Operacional është një mjet kyç për qeverisjen vendore, duke lidhur vizionin strategjik me veprimet konkrete dhe investimet që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, social dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.



Plani Operacional dhe orientimi i investimeve në kuadër të qeverisjes vendore dhe procesit të planifikimit

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL) për Bashkinë Has përfaqëson një instrument kyç për orientimin strategjik dhe menaxhimin e investimeve në nivel vendor. Ai synon të krijojë një lidhje të qartë midis vizionit dhe prioriteteve të bashkisë, nevojave të komunitetit dhe burimeve financiare dhe administrative të disponueshme, duke ofruar një kuadër praktik për planifikimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore.

Në këtë kontekst, Plani Operacional për Investimet përcakton projektet prioritare, grupet e synuara, periudhën e zbatimit, kostot dhe burimet e financimit, si dhe përgjegjësit për zbatimin dhe rezultatet e pritshme. Ai përfaqëson një program investimesh afatshkurtër 3 vjeçar, i cili mbështet qeverisjen vendore në vendimmarrje të bazuar mbi prioritetet reale të komunitetit dhe kapacitetet e bashkisë.

Hartimi i këtij plani bazohet në disa parime kryesore:

- Nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve të Bashkisë Has, të balancuara me burimet dhe mundësitë e bashkisë;
- Perspektiva e qeverisjes vendore dhe objektivat strategjikë kombëtarë për decentralizimin dhe zhvillimin lokal;
- Prioritetet e qeverisjes lokale, të përcaktuara nga vizioni i kryetarit dhe dokumentet strategjike të planifikimit;
- Kriteret për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve prioritare që sigurojnë impakt të lartë për komunitetin.

Plani i investimeve përforcon procese të rëndësishme të qeverisjes vendore dhe planifikimit, duke:

- Orientuar investimet drejt nevojave dhe potencialeve të Bashkisë Has;
- Rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e menaxhimit financiar;
- Siguruar transparencë dhe llogaridhënie në përdorimin e fondeve;
- Forcuar bashkëpunimin dhe komunikimin midis stafit të bashkisë dhe aktorëve vendorë;
- Përmirësuar infrastrukturën dhe cilësinë e jetës së qytetarëve në të gjithë territorin e bashkisë.

Përmes këtij Plani Operacional, Bashkia Has synon të krijojë një qasje të integruar dhe të koordinuar për investimet dhe projektet zhvillimore, duke siguruar që çdo aktivitet të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të komunës dhe të shërbejë si udhërrëfyes për proceset e ardhshme të planifikimit dhe vendimmarrjes në nivel lokal.



Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal (POZHL)

Metodologjia e ndjekur kombinoi informacionet prej burimeve parësore dhe dytësore, me ngritjen e strukturave udhëheqëse dhe analizuese, si dhe përdorimin e metodës 4R (Represenation-perfaqesimi, Resources-burimet, Realia-analizimi i kushteve, Realisationzbatimi) për aspektin e barazisë gjinore. Nëpërmjet kësaj metodologjie dhe në referencë të vizionit dhe nevojave vendore, u synua t'u jepej autoriteteve dhe komunitetit një instrument drejtimi afatshkurtër në fushën e planifikimit dhe zhvillimit lokal. Metodologjia synoi gjithashtu aftësimin e autoriteteve vendore në formulimin, drejtimin dhe monitorimin e POZHL, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore e teknike, si dhe sigurimin e ndjenjës së "pronësisë" tek komuniteti dhe të gjithë aktorët në procesin e planifikimit dhe zhvillimit. Për realizimin e synimit të sipërcituar u ngrit bordi "Për hartimin POZHL" i kryesuar nga kryetari i bashkisë. Bordi përbëhej nga anëtarë që vinin nga zyrat kryesore të bashkisë, administratorë të njësive administrative, drejtues të zyrave të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të biznesit. Bordi udhëhoqi procesin, miratoi ngritjen e grupeve të punës, kriteret për vlerësimin dhe identifikimin e projekteve prioritare, vizionin dhe perspektivën e zhvillimit të bashkisë dhe miratoi POZHL. Me qëllim grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre, diagnostikimin e problemeve dhe përzgjedhjen e projekteve prioritare, u ngritën pesë grupe pune:

- Zhvillimi ekonomik.
- Burimet natyrore dhe mjedisi i qendrueshëm.
- Infrastruktura dhe shërbimet.
- Mirëqenia Sociale dhe Ekonomike.
- Zhvillimi Rural.

Analiza e Gjendjes Aktuale Informacioni për përgatitjen e POZHL u mblodh duke përdorur të dhëna parësore dhe dytësore. Si burim të dhënash parësore shërbyen intervistat gjysmë të strukturuara me ekspertë dhe zyrtarë të qeverisjes vendore, OJQ vendore, përfaqësues të institucioneve të dekoncentruara, biznesin vendas etj. Intervistat synuan të prekin problematikat që lidhen me të sotmen dhe të ardhmen e zhvillimit të Hass, duke aktivizuar dhe përfshirë potencialet më të mira intelektuale me qëllim arritjen e një konsensusi sa më të gjerë dhe të një ndjenje pronësie mbi gjithë procesin. Si burim të dhënash dytësore shërbyen planet e ndryshme të veprimit, dokumentet strategjike dhe raportet e hartuara nga bashkitë dhe komunat, si edhe dokumentet ekzistuese të organizatave ndërkombëtare, strategjitë sektoriale dhe botime të tjera. Gjithashtu u shfrytëzuan të dhëna nga INSTAT dhe agjencitë shtetërore të dekoncentruara. U përdor metoda e "Analizës së pemës së problemit", e cila përfshin përcaktimin e problemeve kryesore dhe krijimin e lidhjeve shkak-pasojë-problem-efekt. Ndërkohë, për përcaktimin e objektivave dhe prioriteteve operacionale u përdor "Pema e objektivave ose e zgjidhjeve"që në thelb është vazhdim i pemës së problemeve. Për formulimin e vizionit, drejtimeve strategjike dhe perspektivës së zhvillimit u organizua një workshop, ku morën pjesë përfaqësues të bashkisë, të shoqërisë civile dhe intelektualë të zonës, nga ku u përcaktuan dhe drejtimet kryesore të zhvillimit, prioritetet operacionale dhe masat përkatëse për realizimin e tyre. Për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, diagnostikimin e problemeve, përcaktimin e objektivave, prioriteteve dhe projekteve prioritare në aspektin e barazisë gjinore u përdor metoda 4R1. Drafti i POZHL u konsultua me



grupe të interesit nga bashkia, njësitë administrative, zyrat e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, shoqëria civile dhe biznesi, specialistë dhe qytetarë.




Figura 1 - Ndarja administrative e Bashkisë Has.

Bashkia e Hasit është sipas ndarjes së re territoriale është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Bashkia e Hasit ka 11687 banorë që jetojnë në Has (deri në vitin 2023 sipas Censusit), dhe një sipërfaqe prej 393 km² dhe kryeqendër qytetin e Krumës.

Hasi është një krahinë etno-gjeografike me kufij të përcaktuar shumë qartë, i rrethuar pothuajse rreth e qark i gjithë Hasi me lumenjë në mes ngrihet madhështor mali i Pashtrikut me lartësi 1989 m mbi nivelin e detit. Në veri dhe në lindje, Drini i Bardhë dhe dega e tij Ereniku që e ndajnë nga Krahina e Rekës dhe Podrimës (Rrafshi i Drinit). Në jug dhe në perëndim kufizohet me krahinën e Lumës dhe Maleziut me të cilat i ndan Drini i Bardhë dhe i bashkuar dhe sot liqeni i Fierzës, ndërsa në veri-perëndim përroi i Skatinës e ndan nga Butyçi i rrethit të Tropojës.

Relievi: Territori i Bashkisë Has është kryesisht malor dhe kodrinor. Zona është e karakterizuar nga male të larta dhe lugina të thella, duke e bërë atë një zonë të përshtatshme për aktivitete të jashtme dhe për përdorimin e burimeve natyrore.

Lumenjtë dhe Ujërat: Në këtë rajon kalojnë disa lumenj të vegjël dhe përrenj, të cilët janë pjesë e sistemit hidrografik të lumi i Drinit dhe i lumenjve të tjerë që derdhen në të (lumi Krumës, lumi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Vlahnës, lumi Rosmanit, lumi Leshnicës etj,). Ujërat janë të rëndësishëm për bujqësinë dhe përdorimin e ujit në këtë rajon malor. Malësinë e Hasit e drenojnë (lumi) përroi i Krumës, Vlahnës, Rosmanit, Leshnicës, Vranishtit dhe rrjedha e sipërme e përroit të Skatinës. Mes objekteve artificiale ujore përmendim ujëmbajtesit dhe kanalet ujitës të ndërtuar kryesisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Numërohen 20 të tillë. Ato janë të vegjël dhe ndër to përmendim: rezervuari i Planit (llakajve), Dobrunës, Qarrit etj. Pas viteve '90 rrjeti ujitës u dëmtua dhe janë të pakët objektet ujitës që vazhdojnë të egzistojnë sot për të të cilët vazhdimisht punohet për ti mirmbajtur dhe për të rritur kapacitetn e tyre ujmbledhës.

Klima: Malësia e Hasit bën pjesë në klimën mesdhetare paramalore veriore. Hasi dallohet për temperatura paramalore e cila dallohet për verën e freskët dhe dimër të lagësht e të ftohtë më ngrica e dëborë. Temperatura mesatare vjetore arrinë 11.4 ^{0}c (Krumë). Në shpërndarjen mujore të temperaturave vërehet se janari është muaji më i ftohtë me vlera mesatare zakonisht 0.4^0 C - 0.9 ^{0} C. Minimumet absolute të kësaj zone takohen në muajin janar, kur kanë arritur në -19^{0}C për stacionin e Krumës, por shtrirja e tyre kap gjithë periudhën tetor - prill. Temperaturat më të larta takohen gjatë muajit korrik e gusht me shumë pak ndryshime 21^{0}C dhe 22^{0}C për stacionin e Krumës. Maksimalja absolute është shënuar në qytetin e Krumës në muajin korrik me 38.6 ^{0}C.

Flora dhe Fauna: Për shkak të terrenit malor dhe klimës, flora dhe fauna e këtij rajoni janë të pasura. Zona është e mbuluar me pyje, bari dhe bimësi të tjera që mbështesin një larmi specie të kafshëve dhe bimëve.

Burime Natyrore: Në rajon ndodhen disa burime ujore dhe minerale të rëndësishme, që kontribuojnë në ekonominë lokale. (vendburimi kromit Vlahën,Perollaj,Maç etj,).

Popullsia dhe Fshatrat: Bashkia Has përbëhet nga disa fshatra (30 fshatra + një qytet) që janë shpërndarë nëpër këtë terren malorë, dhe shumë nga ata kanë një strukturë të karakterizuar nga zhvillimi tradicional dhe mënyra e jetesës rurale.

Demografia


Popullsia në Bashkinë e Hasit është homogjene. Bashkia ka nën administrimin e vet 30 fshatra, ndër të cilët 12 në Golaj, 8 në Fajze, 6 në Gjinaj dhe 4 fshatra + qyteti në Krumë. Në vijim, Bashkia e Hasit numëron 5,322 familje, ndër të cilat 2,074 në Golaj, 1,758 në Krumë, 1,048 në Fajze dhe 442 në njësinë Gjinaj. E veçantë për këtë bashki është se popullsia e saj është tërësisht rurale. Për më tepër, Bashkia e Hasit është karakterizuar gjithmonë nga emigracioni. Një pjesë e të rinjëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim në vendet e Bashkimit Europian apo në Kosovë.Shumica e të rinjëve lëvizin për ndjekur arsimin e lartë drejt kryeqytetit, për këtë arsye, popullsia përbëhet më së shumti nga mosha e tretë. Sipas Censusit të vitit 2023 bashkia numëron 11,687 banorë që jetojnë në Has, ndërsa sipas Gjendjes Civile kjo bashki ka një popullsi prej 21,764 banorësh. Nga ky numer, 7 554 persona jane te moshave 15 deri ne 65 vjec. Trendi i përgjithshëm tregon për një tkurrje të popullsisë çdo vit dhe më shumë



Tabela 1 - Populllsia e Bashkisë Has sipas grupmoshave.

Populllsia Has	0-14	15-64	65+
Gjithesej	2 641	7 554	1 489
Meshkuj	1 415	3 565	704
Femra	1 226	3 989	785

Tabela 2 - Grafiku i numrit të popullsisë dhe i familjeve sipas njësive administrative.



Profili Ekonomik

Bashkia Has, e vendosur në verilindje të Shqipërisë, është një zonë me karakteristika kryesisht rurale dhe bujqësore, me një populllsi relativisht të vogël. Ky rajon kufizohet me Kosovën, gjë që ka ndikuar në zhvillimin e tij ekonomik, sidomos në lidhje me tregtinë ndërkufitare. Bashkia Has ka një ekonomi kryesisht rurale, të mbështetur në bujqësi, blegtori dhe tregti ndërkufitare me Kosovën. Këto sektorë përbëjnë burimet kryesore të të ardhurave për populllsinë lokale.

Me një populllsi të shpërndarë në zonat fushore dhe malore, ky rajon ofron mundësi për zhvillim në sektorë të caktuar.

1. **Bujqësia dhe Blegtoria**

- **Bujqësia** është një shtyllë kryesore e ekonomisë lokale. Toka është përdorur kryesisht për prodhimin e drithërave, perimeve dhe frutave. Klima dhe relievi malor ofrojnë kushte të përshtatshme për rritjen e kulturave tradicionale.
- **Blegtoria** është gjithashtu një sektor i rëndësishëm. Banorët lokalë rrisin kryesisht gjedhë, dele, dhe dhi (dhia e hasit njihet për cilësin e lartë të mishit dhe të nënprodukteve të qumështit), duke prodhuar qumësht, mish dhe nënprodukte të tjera blegtorale. Tradita e përpunimit të produkteve blegtorale është e theksuar, megjithëse në shumicën e rasteve bëhet në mënyrë artizanale.



2. Tregtia ndërkufitare

- Afërsia e Hasit me kufirin e Kosovës ka qenë një faktor i rëndësishëm ekonomik. **Tregtia ndërkufitare** ka krijuar mundësi për shkëmbimin e produkteve bujqësore dhe të konsumit. Disa banorë të Hasit shfrytëzojnë këtë afërsi për të kryer aktivitete tregtare në Kosovë, si dhe për të importuar dhe eksportuar mallra.

3. **Remitancat dhe diaspora**

- Një pjesë e madhe e popullsisë së Hasit ka emigruar, kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore, si Mbretëria Bashkuar, Gjermania, Zvicra dhe Italia. **Remitancat** janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në Has. Ato përdoren kryesisht për përmirësimin e kushteve të jetesës, ndërtimin e shtëpive dhe investime të vogla në ekonomi familjare.
- Remitancat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e familjeve, por nuk janë përdorur në mënyrë të gjerë për investime strategjike që do të krijonin punësim të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

4. Turizmi

- **Turizmi** nuk është ende shumë i zhvilluar në Bashkinë Has, megjithatë zona ka një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor për të cilin po punohet për ta ngritur në nivelet e duhura. Male, lumenjë, dhe pyje të dendur ofrojnë një peizazh të bukur që mund të tërheqë turistë të interesuar në ecje, kamping dhe eko-turizëm.

5. **Infrastruktura**

- **Infrastruktura** mbetet një nga sfidat kryesore për zhvillimin ekonomik të Hasit. Rrugët viteve të fundit rikonstruktuar dhe janë asfaltuar rrugë të reja, veçanërisht në zonat rurale dhe malore, duke sjellë një qasjen më të lehtë në tregje dhe shërbime. Përmirësimi i rrugëve dhe lidhja më e mirë me rrjetin kombëtar të transportit është një hap i madh për rritjen e mundësive tregtare dhe turistike.
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe energji elektrike është përmisuar, duke krijuar mundësi për zhvillimin e sektorëve si bujqësia e përparuar dhe turizmi por gjithmon ka hapsira për përmisime në këto dy sektorë.

6. **Punësimi dhe sfidat sociale**

- **Papunësia** mbetet një problem madhor për Hasin. Mundësitë për punësim jashtë bujqësisë janë të kufizuara, por afersia me qytetet si Gjakova, Prizereni, Kukësi iu ka dhënë mundësi për punësim banorëve. Një pjesë e mirë e popullsisë mbështetet në aktivitetet e vogla tregtare ose në ndihmat financiare nga jashtë.
- Një mungesë e madhe në aftësitë profesionale dhe mungesa e arsimit profesional të zhvilluar kanë ndikuar që të rinjtë të kenë pak mundësi për të gjetur punësim të qëndrueshëm, duke i shtyrë ata të emigrojnë.



7. **Potencialet për zhvillim**

- **Zhvillimi bujqësor dhe blegtoral** mund të përmirësohet përmes investimeve në teknologji moderne dhe krijimit të kooperativave bujqësore për të përmirësuar qasjen në tregje.
- **Turizmi** mbetet një sektor me potencial të madh. Me investime të vogla në infrastrukturën e qëndrueshme dhe promovim, Bashkia Has po punonë në zhvillillimin e turizmit natyror dhe kulturor.
- **Tregtia ndërkufitare** po zgjerohet me përmirësimin e lidhjeve infrastrukturore dhe mbështetjen e politikave që lehtësojnë shkëmbimin ndërkufitar.

Bizneset në numrin më të madhë janë të përqëndruara kryesisht në qytet në përjashtim të kompanive që operojnë në industrin e nxjerrjes së mineraleve.

Tabela 3 - Lloji i aktiviteteve

Bujqësi dhe blektori
Industria Ushqimore
Industria Minerare
Ndërtimtari
Tregti
Aktivitet financiar dhe sigurimesh

Bizneset kryesore që mbështesin ekonominë e Hasit janë: **bujqësia dhe blegtoria, tregtia ndërkufitare, dyqanet dhe shërbimet e vogla, transporti dhe logjistika**, dhe **remitancat** nga diaspora. Këto sektorë krijojnë punësim dhe të ardhura për komunitetin lokal.

Për të mbështetur bizneset në Bashkinë Has, po ndiqen këto drejtime:

- **Përmirësimi i infrastrukturës** - Investime në rrugë dhe energji për lehtësimin e aktivitetit ekonomik.
- **Zhvillimi i tregtisë ndërkufitare** - Lehtësira për tregti me Kosovën dhe shtete të tjera fqinjë.
- **Mbështetje për bujqësinë dhe blegtorinë** - Ofrimi i teknologjive moderne dhe subvencioneve për fermerët.
- **Nxitja e turizmit** - Promovimi i turizmit natyror dhe kulturor për të tërhequr vizitorë.
- **Përkrahja e bizneseve të vogla** - Lehtësimi i procedurave dhe ofrimi i granteve apo kredive për bizneset lokale në bashkpunim me donatorë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Burimet Natyrore

Mineralet

Mineralet metalike:

Zona e Hasit ka qenë historikisht e njohur për depozitat e pasura me minerale, veçanërisht kromë dhe bakër. Minierat e kromit dhe bakrit në këtë rajon kanë qenë aktive në të kaluarën, dhe megjithëse aktivitetet minerare janë zbehur, ato mbeten një burim i vlefshëm natyror. Potenciali për shfrytëzim të mëtejshëm të këtyre mineraleve ekziston, veçanërisht me avancimin e teknologjisë së shfrytëzimit dhe rikuperimit të burimeve natyrore.

Mineralet jometalike:

Përveç mineraleve metalike, në Hasi ka edhe depozita minerale jometalike që përdoren në industrinë e ndërtimit, si p.sh. gëlqerorët dhe argjilat. Këto burime mund të jenë të rëndësishme për ndërtimin e infrastrukturës lokale dhe për eksport.

Rrethi i Hasit ka pasuri të shumta minerare përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë, magmatikë dhe metamorfikë kjo lidhet me pasuritë e shumta minerare në këtë zonë. Sasia më e madhe e kromit njihet në Vlahën dhe vendburimi lokalizohet në masivin ofiolitik Tropojë - Has duke u lidhur me vendburimet e Kam - Tropojës për nga lokalizmi. Vendburimi xeheror i Vlahnes njihen 2.5 milion ton xehe kromit, por rreth 0.2 milion ton tashmë janë nxjerrë. Është formuar brenda harzburgitit të varfëruar me lente duniti të bollshme dhe të trasha.18% - 43%. Miniera e Qafë Perollit njihet për një sasi prej 560000 ton Cr me pastërti 26% - 40%. Sipas studimeve në Golaj gjenden rreth 4.5 milion ton rezerva bakër të pashfrytëzuara edhe për shkak të mosfunksionimit të minierës. Fshatrat Vranisht, Vlahën dhe së fundmi Cahan njihen për nëntokë të pasur me Fe-Ni.

Pyjet dhe Bimësia

Hasi ka sipërfaqe të mëdha të mbuluara me pyje, të cilat janë një burim natyror kyç për rajonin. Pyjet përmbajnë lloje të ndryshme drurësh, përfshirë pishën, bredhin, lisin dhe gështenjën. Këto drurë përdoren për dru zjarri dhe për prodhim industrial (si për përpunim druri).

Biodiversiteti:

Pyjet e Hasit ofrojnë një shtëpi për një shumëllojshmëri speciesh të egra, përfshirë kafshë të rralla dhe të mbrojtura, si ujku, ariu dhe kaprolli. Ky biodiversitet natyror është një pasuri e madhe ekologjike dhe krijon potencial për zhvillimin e turizmit natyror.

Hidrografia

Lumenjtë dhe burimet natyrore:

Hasi është i pasur me burime ujore natyrale, duke përfshirë lumenj dhe përrenj të cilët furnizojnë ujë për bujqësi dhe për përdorim të përditshëm. Ndër lumenjtë më të njohur në zonë është Drini i Bardhë, i cili është një nga burimet kryesore të ujit në veri të Shqipërisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Liqenet e vogla dhe ujëmbledhësit:

Në Hasi mund të gjenden liqene të vegjël natyralë dhe rezervuarë, të cilët shfrytëzohen për vaditje dhe për mbajtjen e burimeve ujore gjatë muajve të thatë. Ka mundësi për shfrytëzim më të mirë të këtyre burimeve për qëllime bujqësore dhe energjetike, siç është rezervuari i "Planit".

Potenciali hidroenergjitik:

Lumenjtë dhe burimet natyrore të Hasit ofrojnë mundësi për zhvillimin e projekteve të vogla hidroenergjitike, (Rosmani, Vlahna), duke prodhuar energji të pastër dhe të rinovueshme për komunitetin lokal dhe për eksport në rrjetin kombëtar.

Lumi Krumës

Ai e ka origjinën në burimin e madh karstik të Vrellës dhe derdhet në Liqenin e Fierzës. Ky lumë ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 227 km^2 dhe një gjatësi prej 26.5 km. Vlerat maksimale kryesore të prurjeve i gjejmë në muajin dhjetor me 13% të rrjedhjes së përgjithshme vjetore si pasojë e reshjeve të shiut ndërsa vlerat maksimale të tjera i gjejmë në muajin shkurt si pasojë e burimit të fuqishëm të Vrellës (Krumës). Vlerat minimale kryesore i gjejmë në muajin gusht me 0.53 m3 /sek ose 2% të rrjedhjes së përgjithshme vjetore si pasojë e reshjeve të pakta të shiut dhe avullimit të fuqishëm dhe për shkak të mungesës së formacioneve ujëmbajtëse.



Figura 2 - Gurra e fshatit Domaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Turizmi Natyror, Kulturor dhe Peisazhet

Peisazhi malor:

Hasi është një nga rajonet më të bukura në Shqipëri për nga natyra e tij e paprekur dhe peisazhet malore. Malet e larta, luginat e thella dhe pyjet e dendura krijojnë një peizazh spektakolar që është i përshtatshëm për turizëm natyror, hiking dhe kamping.

Turizmi i aventurës:

Me terrene sfiduese dhe natyrë të paprekur, Hasi ofron mundësi për zhvillimin e turizmit të aventurës, përfshirë ecje në male, alpinizëm dhe çiklizëm malor. Zhvillimi i infrastrukturës për këto aktivitete mund të sjellë përfitime të mëdha ekonomike për komunitetin lokal.

Trashëgimia kulturore:

Përveç burimeve natyrore, Hasi ka edhe një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike që mund të jetë tërheqëse për turistët, si rrënojat e kalave dhe vendbanimeve të vjetra, si dhe traditat lokale të përpunimit të artizanateve dhe muzikës tradicionale.





Figura 3 - Kullë tipike e zonës së Hasit në fshatin Letaj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Përcaktimi i problemeve dhe i prioriteteve afatshkurta operacionale


Për analizën e problemeve u përdor metoda "Analiza në trajtë peme e problemit" që përfshin përcaktimin e problemeve kryesore dhe krijimin e lidhjeve shkak-pasojë-problem-efekt. Qëllimi kryesor i analizës ishte identifikimi dhe adresimi i vazhdueshëm i shkaqeve bazë (dhe jo i simptomave të problemit).

Në vijim pema e analizës së problemit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA

Për përcaktimin e objektivave dhe prioriteteve operacionale u përdor "Pema e objektivave ose e zgjidhjeve", e cila në thelb është vazhdim i pemës së problemeve. Ajo ndjek rrënjët e problemit dhe përpiqet t'i "kurojë" ato duke çuar në zgjidhjen e vetë problemit. Formulimi i objektivave fillon me shndërrimin e problemeve, shkaqeve dhe efekteve në fjali pozitive, duke ngritur një pemë "pozitive".
Në vijim pema e objektivave/prioriteteve:



Analiza nëpërmjet "Pemës së problemit" dhe "Pemës së objektivave/zgjidhjeve" përcaktoi si probleme kryesore:

- qasjen e vështirë në infrastrukturën rurale;
- nivelin e ulët të zhvillimit bujqësor dhe blegtoral;
- resurset dhe shërbimet turistike të pashfrytëzuara për zhvillimin e turizmit;
- gjendjen mjedisore në standardet jo të duhura; dhe
- kapacitetet administrative dhe financiare të pamjaftueshme.

Zgjidhja e këtyre problemeve synohet të arrihet nëpërmjet objektivit: Nxitja e zhvillimit të qendrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të udhëhequr nga komuniteti.

Realizimi i objektivit të sipërcituar do të kryet nëpërmjet pesë prioriteteve operacionale:

Prioriteti 1

Sigurimi i aksesit dhe jetës normale nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në zonat rurale e urbane.

Prioriteti 2

Shfrytëzim i plotë i potencialeve në bujqësi e blegtori nëpërmjet krijimit të infrastrukturës mbështetëse moderne dhe nxitjes së ekonomisë së shkallës.

Prioriteti 3

Zhvillimi i zinxhirit të vlerës së një turizmi cilësor dhe të shumëllojshëm dhe shndërrimi i tij në një nga burimet kryesore të mirëqenies në Bashkinë Has.

Prioriteti 4

Investimi në burime njerëzore të kualifikuara për përballimin e sfidave të konkurencës globale.

Prioriteti 5

Menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mjedisit nëpërmjet planifikimit të integruar urban dhe rural të territorit si edhe qeverisjes së mirë.

Prioriteti 6

Zhvillimi i infrastrukturës arsimore, shëndetësore e sociale moderne për rritjen e përfshirjes sociale dhe kohezionit social në dobi të një jetese cilësore në Bashkinë e Hasit. Formulimi i synimeve strategjike:

1. Bashkia Has do të karakterizohet nga një zhvillim ekonomik dinamik dhe i qëndrueshëm, duke reduktuar pabarazitë në zhvillim midis zonës urbane dhe rurale të saj dhe konkurruar me sukses si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.

2. Bashkia Has do të forcojë mbështetjen sociale me synim rritjen e barazisë sociale duke kontribuar në rritjen e kohezionit social dhe ekonomik.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Bashkia Has – një komunitet i gjallë
dhe tërheqës, me potenciale të
shfrytëzuara dhe cilësi të lartë jetese.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Plani operacional Lokal dhe i Investimeve

Prioriteti 1

Sigurimi i aksesit dhe jetës normale nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në zonat rurale e urbane.

Masa 1: Ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës që gjendet nën kompetencat e bashkisë.
Prioriteti 2

Shfrytëzim i plotë i potencialeve në bujqësi e blegtori nëpërmjet krijimit të infrastrukturës mbështetëse moderne dhe nxitjes së ekonomisë së shkallës.

Masa 1: Rikonstruksioni i sistemeve ujitëse e kulluese.

Masa 2: Ndërtimi i tregjeve dhe pikave moderne të magazinimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

Masa 3: Ndërmarrja e nismave për eliminimin e copëzimit të fermave dhe krijimin e ekonomisë së shkallës.

Masa 4: Stimulimi nga ana e pushtetit vendor i mekanizmave financiare për subvencionimin e imputeve dhe investimeve.

Prioriteti 3

Zhvillimi i zinxhirit të vlerës së një turizmi cilësor dhe të shumëllojshëm dhe shndërrimi i tij në një nga burimet kryesore të mirëqenies në Bashkinë Has.

Masa1: Rikonstruksioni i monumenteve kulturore dhe objekteve të tjera në funksion të turizmit. • Masa 2: Përmirësimi i infrastrukturës turistike informuese.

Masa 3: Përmirësimi i marketingut territorial për Bashkinë Has.

Masa 4: Rritja e vizibilitetit të resurseve turistike.

Masa 5: Kualifikim i burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të turizmit.

Masa 6: Promovimi i traditave më të mira të artizanatit vendas dhe zhvillimi i tij në funksion të turizmit

Masa 7: Përmirësimi i subvencionimit për aktivitetet start up në fushën e turizmit.

Masa 8: Planifikim strategjik i zhvillimit të Turizmit në Bashkinë Has.

Masa 9:

Gjallërimi i jetës kulturore, artistike e sportive.



Prioriteti 4:

Investimi në burime njerëzore të kualifikuara për përballimin e sfidave të konkurrencës globale.

Masa 1: Studimi i nevojave të tregut dhe nxitja e profilizimit të punëkërkuesve në përputhje me to.

Masa 2: Investim në ngritje të kapaciteteve të administratës publike për shërbime cilësore ndaj publikut dhe në kuadër të integrimit europian.

Masa 3: Nxitja e frekuentimit të arsimit profesional nga të rinjtë.

Prioriteti 5:

Menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mjedisit nëpërmjet planifikimit të integruar urban dhe rural të territorit si edhe qeverisjes së mirë.

Masa 1: Planifikim i integruar i zhvillimit urban e rural në Bashkinë Has dhe krijimi i Agjencisë së Zhvillimit Vendor dhe Grupeve të Veprimit Lokal (LAG).

Masa 2: Planifikim i mbarështimit të pyjeve e kullotave.

Masa 3: Krijimi i strukturave për inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të transferuara Bashkisë.

Masa 4: Modernizimi i ofrimit të shërbimeve nga bashkia për qytetarët nëpërmjet ngritjes së one stop shopeve dhe promovimit të qeverisjes së mirë.

Masa 5: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit nga dëmtimet dhe prej shfrytëzimit pa kriter të burimeve natyrore.

Prioriteti 6: Zhvillimi i infrastrukturës arsimore, shëndetësore e sociale moderne për rritjen e përfshirjes sociale dhe kohezionit social në dobi të një jetese cilësore në Bashkinë e Hasit.

Masa 1: Rikonstruksion i ambienteve shkollore e shëndetësore të amortizuara.

Masa 2: Kryerja e ndërhyrjeve për përfshirjen dhe trajtimin e grupeve vulnerabël dhe riaftësimin e viktimave të trafikut dhe dhunës.

Masa 3: Lehtësimi i aksesit tek shërbimet dhe punësimi i personave PAK.

Masa 4 Sigurimi i strehimit për familjet në nevojë.

Masa 5 Krijimi i programeve për gjallërimin e punësimit.

POZHL në kuadër të planifikimit strategjik dhe Territorial

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" u jep bashkive kompetenca dhe përgjegjësi në lidhje me hartimin e planeve strategjike e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor; organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik; planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit; mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël; si dhe për planifikimin, administrimin, zhvillimin e disa shërbimeve kryesore për qytetarët dhe të infrastrukturës vendore rrugore/arsimore/shëndetsore/bujqësore etj.

Në referencë të këtij ligji:

- POZHL nuk e shikon zhvillimin vendor të izoluar dhe përgjegjësi ekskluzive të bashkisë, por si një përgjegjësi e të gjithë aktorëve të bashkisë, institucioneve të dekoncentruara, komunitetit sipërmarrës dhe shoqërisë civile në territor.
- Filozofia e përdorur në procesin e hartimit të POZHL ishte ndërveprimi dhe partneriteti mes të gjithë aktorëve duke i dhënë bashkisë qasjen e duhur edhe për proceset e tjera të planifikimit strategjik dhe territorial.
- POZHL mori në konsisideratë të gjithë dokumentat e planifikimit dhe zhvillimit në përdorim nga ish-njësitë vendore.
- POZHL nxori në pah vizionin, prioritetet operacionale dhe projektet prioritare të komunitetit të bashkisë Has duke i dhënë një instrument të rëndësishëm afatshkurtër për planifikimin dhe zhvillimin vendor. Ai shtroi si detyra për të ardhmen hartimin dhe miratimin e (i) Strategjisë për zhvillimin ekonomik, (ii) Planit vendor për zhvillimin e territorit, (iii) Planit të veprimit mbi zhvillimin e turizmit të natyrës dhe rural, (iv) Planit vendor për menaxjimin e mbetjeve, (v) Paktit territorial të punësimit.
- POZHL është në harmoni me dokumentat strategjikë. POZHL është në harmoni, në zbërthim dhe zbatim të qëllimit strategjik 3 "Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor", të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020; të tre objektivave të reformës administrative-territoriale; të Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë 2011-2017; të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020; të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014- 2020; të dokumentit të politikave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Shqipëri 2014- 2018; si dhe të Strategjisë së turizmit për rajonin e Kukësit dhe Strategjisë së zhvillimit rajonal.

Ankeset

Kritere vlerësimi për identifikimin e projekteve prioritare

Në funksion të identifikimit të projekteve pjesë të Planit Operacional të Zhvillimit përzgjedhja e tyre do të bazohet në modelin e prioritarizimit, proces i cili është udhëhequr nga disa kritere vlerësimi:

I. Projekti kontribuon në masat e Strategjive të Zhvillimit (të ish-njësive vendore, qarkut, sektoriale e ndërsektoriale).



II. Projekti adreson prioritetet strategjike të dokumentave strategjikë (p.sh. të zhvillimit rajonal, të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të turizmit, të pyjeve dhe kullotave, të zonave të mbrojtura, të bujqësisë, të sipërmarrjes së lirë etj).
III. Projekti mbështet sektorin prioritar të evidentuara në bashki.
IV. Projekti stimulon sektorin privat me nisma të ngjashme.
V. Projekti adreson zgjidhjen e problemeve sociale dhe kontribuon në përfshirjen sociale.
VI. Projekti mobilizon potenciale zhvillimi në bashki.
VII. Projekti ka efekt zinxhir në sektorë të tjerë dhe në zhvillimin ekonomik në bashki dhe rajon (potenciali ekonomik).
VIII. Projekti adreson një emergjencë në bashkia.
IX. Projekti nxit mjedis të qëndrueshëm.
X. Projekti ka impakt rajonal dhe më gjerë.



SHTOJCA

Detajet e kontaktit	
Institucioni buxhetor	Bashkia Has
Departamenti	Zyra e Planifikim dhe Zhvillim Territori
Emri dhe pozicioni i propozuesit të projektit	Pergjegjes i sektorit Novruz Bardhoshi
Detajet e kontaktit të propozuesit të projektit (telefon, email)	E-mail: novruzbardhoshi@gmail.com Tel: 0686265800
Personi i Kontaktit për Buxhetin dhe Financat	Sahit Meshi
Detajet e kontaktit të buxhetit dhe financave	E-mail: sahit.meshi@bashkiahas.gov.al Tel: 0682095147

Identifikimi i investimit			
Ministria/grupi/sektori (Institucioni buxhetor)	MBZHR		
Emri i programit	Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes		
Kodi i grupit	5		
Kodi i projektit	04240		
Numri i identifikimit nga DPIM			
Titulli i Projektit	"Rehabilitimi i digës së rezervuarit të Qarrit" Bashkia Has		
Vendndodhja e projektit	Me shtrirje ne Njesia Administrative Golaj, Bashkine Has		
Statusi i projektit	I ri ■	Lloji i investimit	Shpenzime Administrative ☐ Emergjenca ☐

	Në vazhdim ☐		Shpenzime për Projekte Investimesh ■
Data e parashikuar e fillimit të projektit (muaj, vit)	Janar 2026	Data e parashikuar e përfundimit të projektit (muaj, vit)	Dhjetor 2028
Arsyetimi i Investimeve			
Çështjet aktuale që duhen trajtuar/ Arsyetimi i nevojës për investime Përshkrimi i situatës aktuale përfshirë analizën gjinore të situatës dhe problemeve të perceptuara nga gratë dhe burrat përfitues/e direkt të investimeve. Përshkrimi i çështjeve aktuale dhe nevojave të ardhshme duhet të përmbajë sa më shumë të dhëna sasiore dhe cilësore të ndara sipas gjinisë (dhe disagregimeve te tjera demografike, moshës, etnisë, etj, kur është e mundur). Tregoni problemin kryesor që projekti duhet të zgjidhë dhe shkaqet dhe efektet specifike të problemit kryesor. Jepni arsyetimin për projektin dhe listoni arsyet për të investuar në project.			Kontrolli i cilësisë Dështon = Dështon për të përshkruar problemin ose problemi i përshkruar nuk

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Në kushtet klimaterike të vendit tonë, me verë të nxehtë e të thatë, e ben ujitjen e tokave nujqesore nje faktor shumë të rëndësishëm për rritjen e prodhimit bujqësor, për më tepër, që ne sezoninet e fundit te ujitjes mund të themi se kemi paksim të ndjeshem te rreshjeve vjetore (verë me thatsirë të tejzgjatur), nga ku ka rezultuar me sezoni ujites te zgjatur me rreth 1 muaj (kerkohet uji per ujitje edhe gjate muajit Shtator) Në këto kushte, eshte e nevojshme, qe te merren masa per perdorimin sa me eficent te ujit per ujitje, nga burimi ujor deri tek dergimi i ujit ne parcele. Kjo do te thote nder te tjera minimizimin maksimal te humbjeve te ujit gjate shperndarjes. Ne kete konteks, projekti i propozuar "Rehabilitimi i digës së rezervuarit të Qarrit" Bashkia Has ka te beje I ndertuar ne vitin 1972. Realizimi i këtij projekti është tepër i domosdoshëm për rreth ku perfitojne tre fshatra 2500 banorë, 180 ha toke, fshatrat, Golaj, Perollaj, Zahrisht. Domosdoshmeria e rehabilitimit te kesaj dige ka te beje edhe me faktin se ky ujembledhes ujitese eshte ndertuar ne vitin 1972 dhe pas viteve 90 nuk është investuar per rehabilitim e sajë (sidomos shkarkuesi katastrofik, skarpata e jashtme e diges, tubacioni I ujëleshuesit I cili eshte I demtuar dhe filtron në trupin e diges). Ne kete konteks Bashkia Has u angazhua ne hartimin e nje projekti te plote zbatimi qe konsiston se pari ne rehabilitimin e skarpates se jashtme te digës, ndertimin e drenazheve te trupit të diges, sistemimi I kurores se diges, rehabilitimi total I shkarkuesit kotostrofik. Zbatimi i ketij projekti do te lejoje shfrytezimin me kapacitet te plote te këtijëobjekti dhe plotesimi i nevojave per uje te rreth 185 familje fermereve ne kete bashki sidomos ne periudhen 15 Qershor -31 Gusht. Ky investim në infrastrukturën e ujitjes bazohet ne detyrat e percaktuara per Bashkite sipas nenit 15, te ligjit nr.24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit" dhe është një shërbim publik në interes të bujqesise	konsiderohet i rëndësishëm Jo i qartë = Nuk ka informacion numerik dhe/ose cilësore të mjaftueshëm për shkallën e problemit Kalon = Problemi dhe shkaqet e tij shpjegohen plotësisht me disa dëshmi të shkallës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Objektivat dhe synimet e Projektit Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) janë përfitimet afatgjata që synon të arrijë investimi. Këto objektiva zakonisht vendosen në nivel Programi. Objektivat specifikojnë pse projekti është i nevojshëm për përfituesit e drejtpërdrejtë të investimit. Tregoni qartë objektivat që propozuesi synon të përmbushë me këtë propozim. Ato duhet të jenë një zgjidhje për problemin e përmendur më parë. Duhet të ketë një objektiv të vetëm parësor të shprehur në jo më shumë se dy ose tre fjali dhe objektiva të mëtejshëm specifikë. Vini re se objektivat duhet të jenë specifikë, të matshëm, realistë dhe të përcaktuar në kohë.	Kontrolli i cilësisë Dështon = Objektivat nuk e zgjidhin problemin kryesor Jo i qartë = Objektivat e përshkruara zgjidhin problemin pjesërisht Kalon = Objektivat e përshkruar qartë si një zgjidhje për problemin
Zbatimi i ketij projekti synon garantimin e nje funksionimi dhe sigurin e objektit dhe me kapacitet te plote te Rezervuarit të Qarrit, per te mundesuar nje ujitje te qendrueshme gjate gjithe sezonit ujites prill- shtator, te rreth 180 ha toke bujqesore ku fermeret mund te aksesojen ujin per ujitje sipas nevojave, nepermjet kanalin kryesore si nje mundesi me ndikim ne rritjen e prodhimit bujqesore e per rrjedhoje edhe te ardhurave te tyre	
Nëse PPP konsiderohet si një opsion prokurimi, ju lutemi paraqisni një arsyetim të qartë pas një arsyetimi të tillë. Nëse propozuesi i projektit mendon se PPP është një mënyrë e mirë për të zbatuar idenë e projektit, duhet të tregohet dhe shpjegohet këtu. Krahasimi fillestar ndërmjet prokurimit tradicional dhe PPP-ve (pro dhe kundër) duhet të paraqitet këtu, nëse është e aplikueshme.	Kontrolli i cilësisë Dështon = Nuk ka përpjekje serioze



